

Sistemi i Pensioneve Private të Rumanisë

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare

IOPS, 2015

SISTEMI I PENSIONEVE PRIVATE TË RUMANISË **i paraqitur shkurtimisht**

SISTEMI I PENSIONEVE PRIVATE TË RUMANISË

Shtylla e Dytë

- **Pranueshmëria e Anëtarëve** – E detyrueshme <35 vjeç; Vullnetare (35-45 vjeç); Asnjë regjistrim pas 45 vjeç.
- **Regjistrimi** – ASNJË mos-pjesëmarrje.
- **Kontributet** – kontributet e sigurimeve shoqërore ndahen ndërmjet Shtyllës së parë & Shtyllës së dytë (5% në vitin 2015)
- **Llogaritë dhe Transferimi** – llogaria individuale është e trashëgueshme; anëtari mund të bëjë transferime çdo 2 vjt pa asnjë tarifë transferimi
- **Fondi i Pensioneve dhe kompania për menaxhimin e fondit të pensioneve (PFMC)** - PFMC-të janë ente të posaçme – menaxhimi i fondeve të pensionit është objekti i vetëm i aktivitetit.

Shtylla e tretë

- **Pensionet vullnetare**
- Do të përshkruhet më tej në këtë prezantim.

Sistemi i Pensioneve Private – Numri i anëtarëve & Aseteve

Shtylla e dytë

Numri i Anëtarëve

- **6,4 milionë**
- Rritje mbi 4 % çdo vit

Asetet

- **4,86 miliardë euro**
- Rritje mbi 38 % çdo vit

Shtylla e tretë
Pensionet Vullnetare

Numri i Anëtarëve

- **0,36 milionë**
- Rritje mbi 11% çdo vit

Asete

- **0,25 miliardë euro**
- Rritje mbi 29 % çdo vit

Shtylla e tretë – Pensionet Vullnetare

Pranueshmëria e Anëtarëve & Regjistrimi



Anëtarët janë punonjës, persona që zhvillojnë aktivitete të pavarura, etj.



Regjistrimi në fondin e pensionit është një vendim individual, megjithëse kontributet përgjithësisht paguhen nëpërmjet Punëdhënësit.



Regjistrimi realizohet nëpërmjet disa lloje entesh (komisionerë, ndërmjetës, agjentë) të licensuara për këtë qëllim.
Është e ndaluar që ato të përfshihen në procesin e transferimit individual.

Kontributet & Llogaritë Individuale

Kontributet


- Kontributet mund të paguhen nga punëdhënësi, nga anëtari, ose nga të dy prej tyre.
- Kontributet janë të zbritshme, si për anëtarin, ashtu edhe për punëdhënësin, brenda limiteve të parashkruara nga ligji

Llogaria individuale - (Të njëjtat kushte si për Shtyllën e dytë)

- Është e trashëgueshme
- Nuk mund të konfiskohet ose përdoret si kolateral për kredi.
- Anëtari mund të transferojë në çdo lloj kohe llogarinë e tij/të saj në çfarëdo fondi pensioni.
- **Asnjë tarifë transferimi**, nëse transferta ndodh pas 2 vjetësh nga regjistrimi.

Fondi i Pensioneve dhe kompania për menaxhimin e fondit të pensioneve (PFMC)

- Fondet e pensioneve nuk kanë asnjë personalitet ligjor.
- PFMC-të janë: Kompanitë e Pensioneve, Sigurimit të Jetës ose Kompanitë për Menaxhimin e Investimeve dhe përfaqësojnë fondet e pensioneve në të gjitha marrëdhëniet me palët e treta.
- PFMC-të lejojnë të menaxhojnë disa fonde pensionesh
- Asetet PFMC dhe asetet e fondeve të Pensionit janë të ndara ligjërisht (ring-fenced)



Kufijtë e investimeve & investimet faktike

Bonot qeveritare BE	< 70%	63,68 %
Kapitalet EEA	< 50%	21,40 %
Bonot Bashkiake EEA	< 30%	N/R
Bonot Qeveritare Jo-BE	< 15%	N/R
Bonot Bashkiake Jo-BE	< 10%	N/R
Bonot e Korporatës	< 30%	4,63 %
Cash (Para), depozita, Bono Thesari	< 20%	3,68 %
Investime të tjera: UCITS, jo-UCITS, ETF, etj.	< 5%	5 %

Elementët e Sigurisë – 1/3

Institucionet që ruajnë pronësitë

Të gjitha asetet fondeve të pensionit mbahen në ruajtje nga bankat që kalojnë një proces miratimi dhe marrin një licencë të veçantë për këtë qëllim.

Audituesit e Jashtëm

Të gjitha fondet e pensioneve dhe PMFC-të e tyre duhet të auditohen nga audituesit që kalojnë një proces miratimi dhe marrin një licencë të veçantë për këtë qëllim.

Elementët e Sigurisë - 2/3

Garancia nominale

Garancitë janë opcionale
– disa nga fondet e pensioneve ofrojnë garanci nominale.

Garancia Relative e Performancës

Nëse përqindja përfitimeve të fondit të pensioneve është më e ulët sesa përqindja minimale e përfitimeve të sistemit për 2 vjet, AMF-ja tërheq autorizimin e PFMC.

Elementët e Sigurisë – 3/3

**Fondi i
Garancisë për
të Drejtat e
Sistemit të
Pensioneve
Private**

Shfaqet kur burimet e PFMC-së janë të pamjaftueshme për të mbuluar garancitë.

**Rregullat për
qeverisjen e
Korporatave**

PFMC-të janë subjekt i kritereve ligjore në lidhje me qeverisjen e korporatave, duke përfshirë kriteret duhura & të përshtatshme.

Avantazhet – Shtylla e tretë

Rrit nivelin e mbrojtjes sociale.

Shtylla e tretë ka për qëllim shtesën e të ardhurave të pensionit që mblidhen nëpërmjet Shtyllës së Dytë dhe të Tretë.

Është më fleksible sesa dy shtyllat e tjera përsa i takon pranueshmërisë së anëtarëve dhe nivelit të kontributeve.

Ul barrën në Shtyllën e Parë.

Sfidat aktuale - Shtylla e Tretë

Të inkurajojë njerëzit që të kursejnë më shumë për pension dhe duke vepruar kështu, të rrisë përmasat e Shtyllës 3 (ka ende përmasat më të vogla nga të treja Shtyllat).

Të rrisë njohuritë dhe edukimin financiar - të rrisë vetëdijen mbi të drejtën e pronësisë për asetet që ekzistojnë në llogaritë e tyre individuale.

Mjedisi jo shumë miqësor financiar dhe i investimeve, për shkak të kushteve aktuale të tregut, të ardhurat janë më të ulta sesa në vitet e mëparshme.

Stimujt e kufizuar tatimorë për kontributet e pensionit.

Sistemi i Pensioneve Private – Hapat e ardhshëm

Mbikëqyrja që bazohet në risk

Faza e pagesës

Zhvillimi i mëtejshëm i kuadrit të pensionit sipas profesioneve – si pjesë e Shtyllës 3.



FALEMINDERIT!